

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.104 /2025	Data: 30.05.2025	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) në lidhje me nenin 8 paragrafi 1 pika 1.2, neni 19 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019) ,nenit 5 pika paragrafi 1.3, nenit 13, nenit 20,si dhe nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010,Vendimin Paraprak 00.Nr.185/2024 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes shprehjes së interesit, Vendimin 00 Nr.23/2025 të datës 31.01.2025 mbi themelimin e Komisionit Vlerësues si dhe njoftimit të datës 19.05.2025 nga Komisioni Vlerësues për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e ofertave, në mbledhjen e mbajtur me 30.05.2025 mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS PALUAJTSHME TË KOMUNËS, Të parcelës Nr.233 ZK Kërrninë (Përmes shprehjes së Interesit)

- 1.Miratohet oferta e përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht parcelën Nr.233-0 ZK Kërrninë me sipërfaqe prej (198029)m² pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut evidentuar sipas certifikatës pronësore, ofertuesit "ECO PARK GROUP SIIPK" në periudhën kohore prej 30 (tridhjetë) vitesh.
- 2.Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, ruajtja dhe rritja e vlerës pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit përkatësisht investimi në sektorin e energjisë së ripërtëritshme, bazuar në planin e biznesit si dhe projektin ideor të paraqitur nga ofertuesit me rastin e hapjes së thirrjes publike bazuar në ofertën e përzgjedhur si me e favorshme nga Komisioni Vlerësues si në piken (1) të këtij vendimi.
- 3.Interesi Ekonomik i Komunës së Istogut lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme është investimi, në sektorin e energjisë së ripërtëritshme dhe realizimi i interesit publik duke bazuar në planin e biznesit dhe projektin ideor duke pas parasysh edhe qiranë vjetore në lartësi prej 0.03/euro për m².
- 4.Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme (për parcelën e përzgjedhur nga komisioni vlerësues) do të përcaktohen në kontratë e cila do të lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të kompanisë përfituese (ofertuese).
- 5.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës se Istogut.
- 6.Me nga një kopje të këtij vendimi të njoftohen: Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis si dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

 REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO DREJTORIA PER KOMUNALITETIN - DREJTORIA URBANE		II
		Nr./Br. 039-27 Nr. i faqe/Bistr 01 Data/Datum 05 / 06 / 2025 ISTOG - ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.105 /2025	Data: 30.05.2025	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) në lidhje me nenin 8 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 19 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019), nenit 5 pika paragrafi 1.3, nenit 13, nenit 20, si dhe nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010, Vendimin Paraprak 00.Nr.185/2024 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes shprehjes së interesit, Vendimin 00 Nr.39/2025 të datës 31.01.2025 mbi themelimin e Komisionit Vlerësues si dhe njoftimit të datës 19.05.2025 nga Komisioni Vlerësues për Zbatimin e Procedurave dhe Vlerësimin e ofertave, në mbledhjen e mbajtur me 30.05.2025 mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS PALUAJTSHME TË KOMUNËS, Të parcelës Nr.500-0 ZK Bellopojë (Përmes shprehjes së Interesit)

- 1.Miratohet oferta e përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht parcelën Nr.500-0 ZK Bellopojë me sipërfaqe prej (423940)m² pronë e paluajtshme e Komunës së Istogut evidentuar sipas certifikatës pronësore, ofertuesit "ECO PARK GROUP SHPK" në periudhën kohore prej 30 (tridhjetë) vitesh.
- 2.Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, ruajtja dhe rritja e vlerës pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit përkatësisht investimi në sektorin e energjisë së ripertërishme, bazuar në planin e biznesit si dhe projektin ideor të paraqitur nga ofertuesit me rastin e hapjes së thirrjes publike bazuar në ofertën e përzgjedhur si me e favorshme nga Komisioni Vlerësues si në piken (1) të këtij vendimi.
- 3.Interesi Ekonomik i Komunës së Istogut lidhur me dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme është investimi, në sektorin e energjisë së ripertërishme, dhe realizimi i interesit publik duke bazuar në planin e biznesit dhe projektin ideor duke pas parasysh edhe qiranë vjetore në lartësi prej 0.03/euro për m².
- 4.Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme (për parcelën e përzgjedhur nga komisioni vlerësues) do të përcaktohen me kontratë e cila do të lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të kompanisë përfituese (ofertuese).
- 5.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të ligjshmërisë nga MAPI-ja dhe për realizimin e tij kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, si dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- 6.Me nga një kopje të këtij vendimi të njoftohen: Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis si dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

	REPUBLIKA E KOSOVËS OPŠTINA ISTOK MUNICIPAL ASSEMBLY	
11		
00	Nr./Br 039- 77	Nr. i faq/Bastr 01
Data/Datum 04.06.2025		
ISTOG - ISTOK		

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

ERUGOVA

